

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **207-23-5283-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Zhvillimi i master-planit për Kompleksion Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë "INSI" SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bregu i Diellit, Qendra Tregtare, nr. 42.,

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044 999 007

(Numri Telefonit)

N/A

(Numri i Faks-it)

Ismajl Baftijari

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

baftijari@gmail.com

(Adresa elektronike)

22.12.2023

(Data e parashtrimit të ankesës)

  
(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Njoftimi për kontratë: 24.05.2023  
Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 15.06.2023  
Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 18.07.2023  
Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 04.09.2023  
Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues: 01.12.2023  
Kërkesa për Rishqyrtim: 06.12.2023  
Vendimi i AK lidhur me kërkesën për Rishqyrtim: 14.12.2023

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

<b>Po</b>	<input type="checkbox"/>					<b>Jo</b>	<input checked="" type="checkbox"/>	
-----------	--------------------------	--	--	--	--	-----------	-------------------------------------	--

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:*

<b>Po</b>	<input type="checkbox"/>					<b>Jo</b>	<input checked="" type="checkbox"/>	
-----------	--------------------------	--	--	--	--	-----------	-------------------------------------	--

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë “INSI” SH.P.K., më 06.12.2023 ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke prezantuar argumentet ligjore që si Operator Ekonomik pjesëmarrës nuk jemi pajtuar me vendimin e Autoritetit Kontraktues, për vlerësimin e projektit ideor fillestar, nga i cili Grupi i Operatorëve Ekonomik Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., Tecnoengineering SRL, Daniele Lauria, Studio Lauria Network, Alb-Architect SH.P.K., jemi vlerësuar me 32.64%, renditur i dyti me më së shumti pikë.

Në Kërkesën për Rishqyrtim INSI ka prezantuar argumente ligjore që ne si OE pjesëmarrës nuk jemi pajtuar me vendimin e AK për vlerësimin e prjekteve ideore, dhe

përmes së cilës kemi paraqitur shkeljet administrative - procedurale dhe shkeljet profesionale, të cilat po ashtu i kemi vërejtur pas kërkesës për qasje.

Në Kërkesën për Rishqyrtim INSI ka ofruar argumente ligjore që mbështesin konstatimet tona se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave ligjore gjatë vlerësimit të projekteve ideore, dhe se ne jemi të vetmit Grup i Operatorëve të përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kriteret e paraqitura nga Autoriteti Kontraktues si në dosjen e tenderit.

Megjithatë, në refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ofron ndonjë kundër argument ligjor në argumentet tona ligjore dhe padrejtësisht refuzon kërkesën e parashtruar.

Duke pas parasysh të cekurat më lartë, Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., si lider i konzorciumit parashtron Ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

## **6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 i LPP-së**  
**Neni 7 i LPP-së**  
**Neni 59 i LPP-së**  
**Neni 80 i LPP-së**  
**Neni 55.22 i Rregullores 001/2022**  
**Neni 55.15 i Rregullores 001/2022**  
**Neni 55.16 i Rregullores 001/2022**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

--

Grupi i Operatorëve Ekonomik Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë INSI SH.P.K., Tecnoengineering SRL, Daniele Lauria, Studio Lauria Network, Alb-Architect SH.P.K., në 20.09.2023 ka dorëzuar ofertën e saj për tenderin me titull: **Zhvillimi i master-planit për Kompleksion Memorial Adem Jashari, në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës**, me numër anonim katërshifror 1111, i cili pas hapjes së Dokumentacionit teknik – projektit ideor, është vlerësuar me 32.64%, renditur i dyti me më së shumti pikë.

Pas kërkesës për qasje më 04.12.2023, ne kemi vërejtur tri lloje të shkeljeve:

1. Shkeljet administrative – procedurale;
2. Shkeljet profesionale;
3. Pretendime tjera

Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial Adem Jashari, në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës gjatë qasjes në dokumente nga ana e jone (Shifra 1111) eshte verejtur se ka shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik, Rregullave 001/2022 dhe Udhezuesit 001/2023 pasi që në qasje kemi kuptuar:

**Me poshtë gjeni shkeljet administrative – procedurale:**

#### **Pretendimi 1.**

- Operatori Ekonomik Polis / ka bere shkleje të Rregullores 001/2022, përkatësisht neni 55.22 Informatat mbi numrin serik, datën, kohën dhe identitetin e zyrtarit pranues si dhe **numrin katërshifror** të zgjedhur nga pjesëmarrësi, për propozimet e pranuar me kohë, do të regjistrohen në formularin standard të aprovuar nga KRPP, Procesverbali i dorëzimit të tenderit pasi që ka zbuluar identitetin e vet, dhe Hapja dhe vlerësimi i projekteve **55.24 Pasi që identiteti i pjesëmarrësve nuk do t'i shpaloset jurisë**, zyrtari përgjegjës i prokurimit do t'i hap zarfet e pranuar me kohë dhe do t'i ndajë zarfet që përmbajnë projektet ideore nga ato që përmbajnë dokumentacionin e kandidatit. Po ashtu ka shkelur LPP konkretisht nenin 80 paragrafi 2 të LPP-së theksohet tutje: 2. Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. **Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.**

#### **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues – Pretendimi 1:**

- Autoriteti Kontraktues – ka aprovuar pretendimin tone te pare duke paraqitur se OE Polis ka shpalosur identitetin e saj, e qe eshte ne kundershitim te plote me nenin 55.24 dhe piken 2 të Identifikimit të pjesëmarrësve, andaj i bije se me kete dokument AK e ka eliminuar nga gara e fazes se dyte OE POLIS.
- AK nuk mund te eliminoi asnje operator ekonomik pa pasur nje vleresim te ri, ketu i bije se AK do te duhej ta kthente lenden ne rivleresim per te diskualifikuar OE Polis.
- Dhe mbi kete vendim OE Polis duke e ditur qe nuk ka paraqitur kerkese per rishqyrtim ishte pale jashte interesit dhe se i njejti mund te ankohet ne fazen e dyte (per eliminimin e paraqitur ne vendimin e dates 14.12.2023 nga AK).

#### **Pretendimi 2.**

- OE Polis – sipas Formularit të Dosjes se Tenderit (FDT) ka bërë shkelje të procedurave administrative ne LPP, pasi qe ka vepruar në kundërshtim: 23.1 - Vendi: Projekti ideor duhet të dorëzohet fizikisht në Zyrën 020 në MKRS (e ndarë në një Original dhe dy kopje) ashtu siç janë të përcaktuar me LPP dhe rregulloret tjera në fuqi. **Ndërsa dokumentacioni tjetër duhet të bashkangjitet në formatin elektronik.** Bazuar në dokumentacionin në qasje ne dokumente zyrtare, kemi verejtur se shifra OE POLIS nuk ka bashkangjitur oferten ne menyre elektronike.

### **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues – Pretendimi 2:**

- Autoriteti Kontraktues – ka refuzuar pretendimin tone duke theksuar se OE POLIS ka paraqitur dokumentacionin elektronik ne USB e qe nuk eshte ne perputhje me ate qe AK ka kerkuar ne FDT pasi qe e ka theksuar qe dokumentacionin duhet te bashkangjitet ne formatin elektronik dhe askund nuk ka theksuar qe duhet te sjellet me USB. Kjo i bije se AK ka tentuar te perdore sinonime te fjalëve per kerkesa te ndryshme qe vet i ka paraqitur.

### **Pretendimi 3.**

- Shifra 2606 – sipas procesverbalit të takimeve (takimit 1) theksohet nga ana e jurisë profesionale se ofertat e kesaj shifre jane te gjitha në një pako. Gjate vizites tone ne Sallen e Vleresimit te ofertave kemi verejtur se kjo shifer i ka të gjitha zarfet e hapura dhe perbenë shkleje prapë të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregulloreve pasi qe Oferta në Konkursin e Projektimit ishte: 1 Original dhe 2 Kopje (Dy kopjet duhet te jene te mbyllura dhe hapen vetem ne procese gjyqesore ose me vendime te OSHP-së). Baza: Neni 55.15 dhe Neni 55.16 Zarfi që përmban Dokumentacionin e Kandidatit do të përmbajë: a. ekzemplarin origjinal të të gjitha kërkesave tjera, (emri, adresa, përshtatshmëria, kërkesat ekonomike/financiare dhe teknike, dhe nëse është e zbatueshme, oferta financiare), e shënuar si Original; dhe b. numrin e kërkuar të kopjeve të dokumentacionit të kandidatit. **Pjesëmarrësi do ta mbyllë ekzemplarin origjinal të dokumentacionit të kandidatit dhe secilën kopje në zarfe të posaçëm dhe në faqen e përparmë të secilit zarf do të: a. Shënojë qartë si Originali – Dokumentacioni i kandidatit ose Kopje – Dokumentacioni i Kandidatit; b. Shënoj numrin e Prokurimit sikurse ceket në dosjen e konkursit të projektimit; c. Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit; dhe d. Paralajmërimi mos e hapni me projektin Ideor.** Po ashtu, kjo shkelje perbenë edhe shkelje te nenit 23.1 të FDT-së ku është cekur: 23.1 - Vendi: Projekti ideor duhet të dorëzohet fizikisht në Zyrën 020 në MKRS **(e ndarë në një Original dhe dy kopje)**

KODI 1 (të emërtuar nga anëtarët e Komisionit, pasi që në këtë rast O.E. ka zbuluar identitetin në të gjithë dokumentacionin e dorëzuar) u konstatua se O.E. ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues të gjitha produktet sipas kërkesës - C të dosjes së tenderit, origjinal dhe dy kopje, dhe atë:

- Produkti 1: Raportet teknike të projektit - në format A4 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Panelet ekspozuese - gjithsej gjashtë (6), në format A0 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Video animacioni - USB e lexueshme.

KODI 2606 (O.E. ka bashkangjitur në një pako të gjithë dokumentacionin, origjinalin dhe 2 kopje) u konstatua se O.E. ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues të gjitha produktet sipas kërkesës - C të dosjes së tenderit, origjinal dhe dy kopje, dhe atë:

- Produkti 1: Raportet teknike të projektit - në format A4 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Panelet ekspozuese - gjithsej gjashtë (6), në format A0 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Video animacioni - CD e lexueshme.

KODI 1111 u konstatua se O.E. ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues të gjitha produktet sipas kërkesës - C të dosjes së tenderit, origjinal dhe dy kopje, dhe atë:

- Produkti 1: Raportet teknike të projektit - në format A4 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Panelet ekspozuese - gjithsej gjashtë (6), në format A0 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Video animacioni - USB e lexueshme.

Faqe 2 nga 3

Numri i Prokurimit: 207-23-5283-2-1-1 - Titulli  
Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari'

### **Përgjigja e Autoritetit Kontraktues – Pretendimi 3:**

- Autoriteti Kontraktues – ka refuzuar pretendimin duke paraqitur se OE ka bashkangjitur Origjinalin dhe dy kopjet ashtu sic është kërkuar në FDT ani pse në raport shkruan, se OE ka bashkangjitur të gjithë dokumentacionin me një pako dhe gjatë vizites sone në vendin e vlerësimit të ofertave shihet qartë se të gjitha ofertat e kësaj kompanie janë të hapura dhe i bje se janë në kundërshtim me vet thirrjen e paraqitur në Autoriteti Kontraktues dhe në kundërshtim të plotë me Pjesëmarrësi do ta mbyllë ekzemplarin origjinal të dokumentacionit të kandidatit dhe secilën kopje në zarfe të posaçëm dhe në faqen e përparmë të secilit zarf do të: a. Shënojë qartë si Origjinali – Dokumentacioni i kandidatit ose Kopje – Dokumentacioni i Kandidatit; Po ashtu i bje se është edhe në kundërshtim me Afatin e fundit të dorezimit ku paraqitet se duhet të dorezohet fizikisht në zyrën 020 e ndare në një origjinal dhe dy kopje.

### **Pretendimi 4.**

- Shifra 2606 – sipas Formularit të Dosjes së Tenderit (FDT) ka bërë shkelje të procedurave administrative në LPP, pasi që ka vepruar në kundërshtim: 23.1 - Vendi: Projekti ideor duhet të dorëzohet fizikisht në Zyrën 020 në MKRS (e ndarë në një Original dhe dy kopje) ashtu siç janë të përcaktuar me LPP dhe rregulloret tjera në fuqi. **Ndërsa dokumentacioni tjetër duhet të bashkëngjitet në formatin elektronik.** Bazuar në dokumentacionin në qasje në dokumente zyrtare, kemi vërejtur se shifra 2606 nuk ka bashkëngjitur ofertën në mënyrë elektronike.

**Përgjigja e Autoritetit Kontraktues – Pretendimi 4:**

- Autoriteti Kontraktues – ka refuzuar pretendimin tonë duke theksuar se shifra 2606 ka paraqitur dokumentacionin elektronik në USB e që nuk është në përputhje me atë që AK ka kërkuar në FDT pasi që e ka theksuar që dokumentacionin duhet të bashkëngjitet në formatin elektronik dhe askund nuk ka theksuar që duhet të sjellet me USB. Kjo i bje se AK ka tentuar të përdorë sinonime të fjalëve për kërkesa të ndryshme që vet i ka paraqitur.

Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	Vendi: <b>Projekti ideor duhet të dorëzohet fizikisht në Zyrën 020 në MKRS (e ndarë në një Original dhe dy kopje) ashtu siç janë të përcaktuar me LPP dhe rregulloret tjera në fuqi. Ndërsa dokumentacioni tjetër duhet të bashkëngjitet në formatin elektronik.</b>
--	--

Jemi të habitur se si AK dhe komisioni ka vlersuar dy OE të cilët de fakto nuk kanë ofertuar fare në e-prokurim (dëshmi foto të bashkëngjitur më poshtë), andaj edhe kemi kërkuar nga AK të përgjigjet në këtë pyetje që sipas kërkesës së tyre në DT sa kompani kanë ofertuar në mënyrë elektronike, të kërkohej nga KRPP interpretim se si juridikisht keni bërë një leshim të tillë.

# PËRMBLEDHJA E PROKURIMIT

## INFORMATA BAZE PËR PROKURIM

<b>Autoriteti kontraktues:</b>	MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK,
<b>Lënda e prokurimit:</b>	Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës
<b>Numri i prokurimit</b>	207-23-5283-2-1-1
<b>Afati për dorëzimin e ofertave:</b>	20.09.2023 02:00
<b>Vlera e parashikuar:</b>	3 000 000,00
<b>FPF Kodi:</b>	74223000-8 Organizimi i konkurseve arkitektonike te projektimit
<b>Lloji i kontratës:</b>	2 Shërbime
<b>Lloji i marrëveshjes kornizë:</b>	Nema
<b>Lloji i procedurës:</b>	1 Procedurë e hapur
<b>Numri total i ofertave:</b>	1
<b>Numri total i kontratave / marrëveshjet kornizë:</b>	0

## NJOFTIMET

Numri i referencës së publikimit	Tipit të dokumentit	Data e dërgimit	Data e publikimit
<a href="#">2023/207-23-5283-2-1-1/B05-0012726</a>	B05 Njoftim per Kontrat	24.05.2023	25.05.2023

Oftuesi	Prokurimi	Autoriteti kontraktues	Lënda e ofertës	Kodi	Afati për dorëzimin e ofertave	Data e pranimit të aplikacioneve	Statusi i ofertës
Grup i Operatorëve Ekonomik Institut i Shkencës Dhe I Teknologjisë Insi SH.P.K. TECNOENGINEERING SRL, DANIELE LAURIA, STUDIO LAURIA NETWORK ALB - Architect SH.P.K.	Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës	MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK	207-23-0283-2-1-1	0918	20.09.2023 14:00	20.09.2023 11:56	Ne vlerësim

Sipas përmbledhjes së prokurimit (bashkëngjitur foto e parë si dëshmi), nënkupton se vetëm një operator ekonomik ka aplikuar online, dhe bazuar në dëshminë e dytë që na tregon tabelën e tenderëve ku kemi aplikuar, nënkuptohet qartë se jemi ne të vetmit Grupi i Operatorëve Ekonomik që kemi dorëzuar ofertën përmes sistemit elektronik, siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

### Sqarime:

**Nga kjo që është paraqitur me lartë vërejtje se:**

Per ekspertin shqyrtues, ekspertin teknik dhe PSH-OSHP, paraqesim:



- Shifra 1111 / duke u bazuar në Procesverbalin e takimit të pare, theksohet që ka dorezuar dokumentacionet sipas kërkesës.
- Shifra 1111 / duke u bazuar në nenin 23.1 të Formularit të Dosjes së Tenderit – ka paraqitur Oferten në formën elektronike ashtu siç është kërkuar në formular.

Kurse, dy Operatoret Ekonomik të paraqitur me lartë edhe si kanë plotësuar kriteret sic duhet edhe nuk kanë ofertuar në formatin e kërkuar nga vet Autoriteti Kontraktues.

Pretendimi 5.

### **Me poshtë gjeni shkeljet apo devijimet profesionale gjatë vlerësimit si dhe përgjigjet e AK në refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim:**

**Përgjigje në pretendimin e AK:** Sipas AK ne kemi bërë komente dhe krahasime për OE tjetër, mirëpo OE 1111 në kërkesën e vet për rishqyrtim nuk ka bërë komente që nuk i takojnë, por ka argumentuar vlerësimin e padrejtë të komisionit në raport me zgjidhjen tjetër në konkurs. Ky argumentim është i pamundur të bëhet pa u krahasuar me opsionet e tjera. Për më tepër OE ka argumentuar që OE1111 i ka qëndruar kërkesave të DT, ndërkohë që është OE2606 që nuk i ka respektuar. Dhe në mënyrë që vlerësimi të jenë i drejtë këto propozime duhen vënë në të njëjtin emerues gjykimi. Dhe ky shqyrtim kërkon një bazë krahasueshmërie. Askund OE nuk ka marrë kompetencat e KV por në tagrin e vet ka kërkuar nga KV ta rivlerësojë mbi këtë bazë krahasuese. Do mjaftonte ky pretendim i Zyrës së Prokurimit për të parë tendencialitetin e KV në vlerësimin paragjykses (i thelluar në propozimin e OE1111), negative dhe të njëanshëm të KV.

Propozimi i shifrës [2606] është i mbivlerësuar vis a vis propozimit të shifrës [1111], ndërkohë që ky i fundit është thellësisht i nënvleftësuar për tërësinë e propozimeve që ka bërë Komisioni Vlerësues.

Në vijim janë të paraqitura disa nga vërejtjet tonë rreth vlerësimit të Projektimit të Peizazhit Kulturor Kompleksi Memorial Adem Jashari nga kompania projektuese me shifrën 2606:

### **MUNGESA E VIZIONIT, QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE**

Shifra 2606 ka dhënë një propozim të përgjithshëm, sipërfaqësor dhe pa vlera të pashtjelluar. Vetë koncepti është i pa trajtuar dhe i pa artikuluar në dokumentin e propozimit.

Koncepti i propozuar nga shifra 2606 është i mangët, steril dhe thjesht një përshkrim sipërfaqësor. Ai nuk është shtjelluar as minimalisht sipas një strukturë të kërkuar pa arritur të ndërtojë VIZION, pa përcaktuar QËLLIME dhe OBJEKTIVA për zhvillim.

Ndërkohë propozimi i shifrës 1111 është i shtjelluar në detaje duke mirë përcaktuar Vizionin për zhvillim, Qëllimet dhe Objektivat specifike me instrumentet përmes së cilëve të realizohen këto objektiva.

Përkundër që është kërkuar me detyrë projektuese, kompleksit memorial të propozuar nga shifra 2606, i mungon të kuptuarit e masterplanit i mungojnë VIZIONI, QËLLIMET dhe OBJEKTIVAT, si dhe më shumë i mungojnë edhe parimet e kërkuara me detyrë projektuese për projektim, kështu që vlerësimi i tij me poena maksimal është i çuditshëm kur merren për bazë gjithë këto mungesa.

## **MUNGESA E NJË PLANIFIKIMI SPECIFIK KUNDREJTË KONTEKSTIT TË LOKACIONIT, NGJARJEVE HISTORIKE DHE DETYRËS PROJEKTUESE**

Metodologjia e shifrës 2606 është një tekst gjenerik dhe shumë i përgjithshëm, dhe si i tillë mund të aplikohet për çfarëdo lloj iniciative apo projekti për ndonjë lokacion ose detyrë projektuese tjetër, pasi që nuk artikulon qasjen konkrete në realizimin e këtij projekti shumë specifik.

Ndërkohë që shifra 1111 ka shtjelluar në detaje metodologjinë dhe qasjen në të cilën do bazohet dhe referencat në dokumentet zyrtare dhe metodologjinë zyrtare të planifikimit për të arritur objektivat e vëna nga detyra e projektimit.

Po kështu koncepti kuratorial i shifrës 2606 është i vakët, i përgjithshëm dhe nuk ndërton mbi vlerat e zonës. Ai e sheh projektin në mënyrë të ngushtë brenda 'infrastrukturës' ekzistuese pa ndërtuar në realitet një narrativë të qenësishme për të gjithë kompleksin dhe zonën. Ky koncept është një riprodhim i varfëruar i detyrës së projektimit dhe nuk lejon të ndërtohet diçka inspiruese në këtë projekt.

Nëse shihet si përmbajtje e përgjithshme shifra 2606 lirshëm mundë të thuhet se ka një trajtim minimal shkollor të kompleksit memorial, deri sa shifra 1111 heroizmin e familjes i cili është unik dhe i vetëm në botë si pjesë të kompleksit memorial e shef si gurthemel për intervenimin e NATO-s dhe rezolutën 244 rrjedhimisht lirinë dhe paqen në Kosovë që janë rezultat i sakrificës dhe heroizmit të familjes Jashari, andaj trajtimi i kompleksit memorial si vlerë botërore me synim në UNESCO (pasi që UNESCO ka filluar të vendos nën mbrojtje edhe komplekset memorialë), në krahasim me trajtimin e shifrës 2606 si vlerë e rëndomtë lokale fuqishëm flasim për dy vizione dhe koncepte të ndryshme e ne jemi të bindur se është në interes të Kosovës por edhe gjithë shqiptarëve që kompleksi memorial të trajtohet në vlerën e vet reale, si vlerë botërore dhe lirshëm mundë të themi se nuk ka rast të ngjashëm në histori të njerëzimit, është e çuditshme dhe jonormale që këtë vlerë kombëtare në nivel lokal.

Jemi të bindur se shqiptarët për arsye të vlerave të familjes Jashari dhe deri më tani e kanë vizituar dhe do të vazhdojnë ta vizitojnë këtë memorial, por vizioni qëllimet dhe objektivat e shifrës 1111 kanë qene qe sakrificën dhe heroizmin e familjes Jashari ta vendosin me përmbajtje arkitektonike dhe përmbajtje te tjera ashtu qe te nxite vizitat me numër te madh të vizitorëve të huaj, duke shndërruar këtë kompleks në qendër botërore të sakrificës heroizmit dhe paqes, për çka nga shifra 1111 është vendosur edhe panteoni i nobelistëve të paqes si simbol i sakrificës së familjes Jashari për paqe i intervenimit të NATO – s për paqe dhe rezolutës 1244 për paqe globale, por të njëjtën kohë duke vendosur një panteon i cili do te nxitë ardhjen e nobelistëve të cilat janë gjallë, të institucioneve me çmim Nobel, të organizimit të konferencave dhe ngjarjeve të nivelit botëror për paqe por edhe nivelit kombëtar e rajonal edhe për më shumë nxitjen e shumë vizitorëve të huaj, paqe më shumë është te panteoni i paqes është planifikuar edhe për nobelistët e ri që do të shpallen në ta ardhmen, ku edhe atyre do të ju ngritët shtatorja me ç'rast kompleksin memorial do e mbajmë gjallë me organizime dhe aktivitete të ndryshme.

Me detyrë projektuese është kërkuar ringjallja e ngjarjes historike të 5,6 dhe 7 marsit, nëse shihet koncepti dhe metodologjia e shifrës 2606 asnjë trajtim serioz që bënë një ringjallje apo rikujtim të kësaj ngjarje nuk është trajtuar, përderisa tek shifra 1111 janë trajtuar 59 shtatore të nobelistëve të paqes ashtu siç i ka quajtur Bernard Kushner te cilët do të jenë punuar nga materiali i gomës që është 98 – 99% afër pamjeve reale të dëshmorëve ose për shkak të

qëndrueshmërisë më të gjatë nga materiali i bronzit me ngjyrë i cili është afër 95% i dukjes reale të dëshmorëve.

Vendosja e tyre nëpër kulla dhe shtëpi është një përmbajtje kryesore që do ta ringjallë komplet ngjarjen me 5,6 dhe 7 marsit edhe vendosja e tyre nëpër shtëpitë origjinale të tyre do ti mundësoj vizitorit edhe emocion edhe një përjetim të veçantë ngjarjes dhe rinjohje të komplet 59 dëshmorëve dhe kontributit dhe sakrificës të burrave dhe grave në këtë ngjarje.

Kërkesa për organizim të dinjitetshëm dhe institucional të ceremonisë së 5,6 dhe 7 marsit në metodologjinë e shifrës 2606 është i mangët, jofunksional dhe joadekuat.

Mungesa e parkingut në zonë, mungesa e një ceremonie serioze të Natës së Zjarreve përveç zëvendësimit me drita në tri kullat të cilat edhe ashtu nuk do të kenë ndonjë risi sepse do të jenë në mënyrë të vazhdueshme të ndezura.

Për më tej, metodologjia e propozuar për konservimin e ndërtesa është shumë e vobektë dhe nuk është e qartë çfarë ndërhyrje janë propozuar. Për dallim nga propozimi me shifrën 1111, propozimi me shifrën 2606 nuk ka dorëzuar një metodologji të qartë të konservimit, konceptin kuratorial apo detaje të konstruksionit të qelqit mbrojtjes të kullave të familjeve të Adem dhe Hamëz Jasharit.

## **MUNGESA E DIVERSITETIT TË FUNKSIONEVE DHE HAPËSIRAVE ADEKUATE PËRCJELLËSE KUNDREJTË KONTEKSTIT TË LOKACIONIT, NGJARJEVE HISTORIKE DHE DETYRËS PROJEKTUESE**

Përkundrazi, shifra 1111 e ka paraparë konceptin kuratorial si një zhvillim i të gjithë zonës duke e trajtuar si një organizëm që do funksionojë me të gjithë diversitetin e funksioneve të të gjithë elementëve në zonë duke integruar aspekte të ndryshme të zhvillimit, si aspekti i trashëgimisë historike dhe aspekti i socio-ekonomik i zhvillimit.

Koncepti i ofruar nga shifra 2606 është i varfër në funksione, modest në objektiva dhe për rrjedhojë nuk do sjellë asnjë zhvillim të qenësishëm në zonën e Prekazit.

Amfiteatri i vendosur me fokus ka varrezat e reja të fshatit ( të cilat edhe ashtu nuk e kanë vendin në kompleksin memorial, Në asnjë rast në botë nuk e gjen një rast të tillë), për më shumë pozita e amfiteatrit me shpinë të kthyer nga varrezat e familjes Jashari është zgjidhja më joracionale dhe e papranueshme, për më shumë mundë të quhet edhe skandaloze.

Në krahasim me konceptin e shifrës 1111, vërtetë është për të u habitur se si ka mundësi të vlerësohet me kaq shumë pikë shifra 2606. Kjo qasje e vlerësimit në mënyrë të qartë lenë për të nënkuptuar se është me tendencë dhe qëllim favorizimi jomeritor të konceptit të mangët të shifrës 2606, për shkak se:

1. Kthimi i ish-fabrikës së municionit me një sipërfaqe prej 3500m<sup>2</sup> në muze nacional të rezistencës është zgjidhja më joracionale dhe jofunksionale në raport me kërkesat e detyrës projektuese, ju përkujtojmë se është kërkuar hapësire për vendosjen e përmbajtjeve si konferenca, workshope, shfaqeje, koncerte, etj, e jo vetëm hapësirë muzeale. Vendosja e muzeut nacional në një distancë prej 3km nga kullat e Jasharajve nga shifra 2606 vërtetë është e çuditshme, joracionale dhe jofunksionale (vetëm paramendoni dikë që viziton kompleksin memorial i duhet të përshkojë një rrugëtim deri në 3km për të arritur në muze), derisa shifra 1111 ish fabrikën e municionit e ka planifikuar ta shndërroj nga një pikë ku është prodhuar municion i cili është përdorur për

dhunë dhe terror ndaj shqiptarëve në një sallë ku mundë të organizohen konferenca, workshope, shfaqje, koncerte të nivelit rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar e sidomos simbolika e kthimit të këtij vendi në një vatër ku përkujtohet historia me fotografi dhe mundësi vizuale, mirëpo që promovon paqe botërore është në funksion të vizionit që shifra 1111 ka për vendosjen e kompleksit memorial nga niveli kombëtar në nivel botëror duke e planifikuar muzeun në hapësirat afër kullave të Jasharajve dhe duke krijuar funksionalitet dhe racionalitet, është e çuditshme dhe shumë tendencioze se si ka qenë e mundur që shifra 2606 të vlerësohet me poena maksimal.

**Përgjigje në pretendimin e AK:** Në pretendimin e tyre me të njëjtin paragjykim vlerësohet që OE1111 të ketë dalë jashtë detyrës së projektimit pasi ka zgjidhur problematika urbanistike që sot kompleksi ekzistues veçse i ka dhe nuk mund të rrijnë pa u trajtuar. Konservim nuk do të thotë të konservohen edhe problematikat, ngecjet apo gabimet funksionale të zonës apo kompleksit.

Trajtimi i sheshit si pedonal, zhvendosja e varrezave të fshatit, eliminimi i disa ndërtimeve pa leje, integrimi i kompleksit të shtepiave të fisit Jashari (që nuk janë pjesë e kompleksit ekzistues, por që janë subjekt konservimi), pajisja e sheshit me aksesore të domosdoshëm për të zhvilluar ceremoni përkujtimore, pasurimi i funksioneve urbane, zhvendosja e trafikut dhe disiplinimi i parkimit, me sa duket janë totalisht jashtë vëmendjes së KV. Për më tepër çuditshëm KV nuk është shqetësuar nga propozimi i OE2606 që planifikon rrugë që rrënon një pjesë të shtëpive të fisit Jasharaj.

2. Trajtimi i mangët i hapësirave sportive nga shifra 2606 dhe trajtimi si një qendër ku do të zhvillohen gara vendore dhe ndërkombëtare në disa sporte nga shifra 1111 edhe këto flasin për koncepte dhe vizione të ndryshme, njëra e shifrës 1111 e cila synon ta mbajë gjallë kompleksin memorial edhe me ngjarje të tilla ndërsa e shifrës 2606 e cila nuk ka asnjë përmbajtje, është e çuditshme dhe shumë tendencioze se si ka qenë e mundur që shifra 2606 të vlerësohet me poena maksimal.

**Përgjigje në pretendimin (a) e AK:** Vërejtja është një spekulim nga ana e ZP. OE1111 nuk pretendon që hapësirat sportive do mbajnë gjallë kompleksin. Përkundrazi, me sa duket propozimi i OE1111 ose nuk është lexuar ose nuk është kuptuar, megjithëse ka qenë i qartë. Vizioni i hartuar vërteton të kundërtën. Vizioni i strategjisë së ofruar nga OE1111 është Një vend për të çmuar heroizmin dhe sakrificën, një pikë referimi për të lartësuar traditën dhe vlerat patriotike, një platformë për të promovuar paqen dhe vlerat njerëzore, një mjedis për të shijuar jetën dhe vlerat e familjes

Ndërkohë në materialin e hartuar nga vetë Ministria e Kulturës zona Dp është kërkuar që të kenë funksion rekreacional e parkim. OE1111 veçse e ka respektuar dhe e ka shtjelluar. Patjetër që të tilla zona, por edhe parqet që janë sugjeruar në plan janë në vetvete element që do të kenë impakt në të gjithë zonën nga pikpamja e vizitueshmërisë, nga pikpamja e rëndësisë historike, nga pikpamja ekonomike dhe ajo sociale. Ky është edhe në qëllimin e projektit. I gabuar, jo profesional, naiv e i qëllimshëm është vlerësimi i KV sipas të cilit zona e rekreacionit (të cilën e ka ideuar vetë autoriteti kontraktues, dhe OE1111 veçse e ka detajuar) do demtojë kompleksin memorial.

3. Trajtimi i tri zonave për banim të qëndrueshëm nga shifra 2606 nuk mundë të konsiderohet as si një detyrë e thjeshtë shkollore, përderisa shifra 1111 i trajton tri zona të banimit me të gjitha përmbajtjet në funksion të kompleksit memorial të cilat përpos aspektit funksional ofrojnë edhe komoditet edhe kapacitete për pranimin e vizitorëve në kompleks memorial, është e çuditshme dhe shumë tendencioze se si ka qenë e mundur që shifra 2606 të vlerësohet me poena maksimal.

**Përgjigje në pretendimin (b) e AK:** Komenti i KV mbi zhvillimin e qëndrueshëm tregon më së miri se si ai pathelluar ka qenë në vlerësimin e vet. Së pari duhet thënë që angazhimi në këtë koncept është kërkesë e vetë garës. Së dyti, OE1111 nuk flet për ndërtime blloqesh kolektivë, dhe nga kjo pikpamje bëhet edhe më i domosdoshëm rishikimi i vlerësimit, pasi që po del dukshëm që KV nuk e njej propozimin e OE1111 ose ngatërron qëllimshëm propozimin. OE1111 mendon që *‘Qëndrueshmëria dhe Mbrojtja e Mjedisit: Një nga aspektet më të rëndësishme të projektit është ndjeshmëria dhe ndërgjegjësimi mbi tema të rëndësishme si zhvillimi i qëndrueshëm dhe mjedisi. Ndaj projekti ndan një segment të rëndësishëm për këtë temë. Ai synon që përmes adoptimit të teknikave dhe teknologjive më miqësore me mjedisin të ndërtojë një shëmbull të një zhvillimi të balancuar. Patjetër që ky aspekt është i kombinuar edhe me aspektin ekonomik. Tashmë shoqëri të përparuara si ajo e Kosovës mund të argumentojnë që ka racionale ekonomike të qenurit i ndjeshëm ndaj aspekteve mjedisore. Jo pa qëllim projekti synon adoptimin e teknikave si Infrastruktura e gjelbër që janë avantgarda e teknologjisë që adoptohet sot në perëndim’*. Pra dukshëm propozimi nuk është në thelb për blloqë banimi kolektiv, por integrim të teknikave të avancuara dhe koncepteve të avancuara siç është “green infrastructure” concept që nuk duhet ngatërruar me gjelbërimin. Me qëllim KV ngatërron propozimin e OE1111 për pasurimin e funksioneve urbane që do ndihmojnë nxjerrjen në pah të vlerave historike të zonës dhe të vetë kompleksit (siç është ndërtimi i Parkut EtnoAlb, Panteonit të Paqes, Muzeut, Hotelarisë mikpritëse, Sallës së kongreseve, amfiteatrit), më ndërtime kompleksesh banimi kolektiv.

4. Derisa në detyrë projektuese është kërkuar që të gjitha shtëpitë të rëndësishme historike të zonës propozohen masa konservimi restaurimi dhe mbrojtje është e çuditshme se shifra 2606 as nuk i trajton në përmbajtjen e plotë për më shumë mbi disa shtëpi projekton edhe rrugë që është në kundërshtim të plotë me kërkesat e detyrës projektuese për të konsoliduar dhe mbrojtur shtëpitë, në krahasim me shifrën 1111 e cila të gjitha shtëpitë me vlera historike dhe të propozuara për mbrojtje ju bënë një trajtim të veçantë me masa një nga një, andaj vërtetë është e çuditshme se si është e mundur të bëhet një vlerësim i tillë i shifrës 2606 kur janë në disharmoni të plotë me kërkesën e detyrës projektuese.
5. Te koncepti i ringjalljes të ngjarjeve historike në zonë derisa shifra 2606 nuk e trajton fare, shifra 1111 ka planifikuar në shtrirje prej 30ha parkun etnoalb i cili ringjallë historinë e shqiptarëve, historinë e Kosovës dhe historinë e Prekazit, duke lëvizur qytet për qytet me një simbol të qytetit shqiptar dhe me anë të argumentit reality AR dhe me QR Code merr informacione të sinkronizuara mbi ngjarjet historike duke bërë edhe vizitorin vendor edhe ndërkombëtar të informuar me historinë e shqiptarëve, Kosovës dhe Prekazit dhe ngjarjeve nëpër vite, në të njëjtën kohë duke ofruar një ambient me mobilieri urbane të përshtatshme për shëtitje dhe rekreacion, duke pasur edhe përmbajtje shërbyese (Kafiteri, ëmbëltores e Restorante të kufizuara në numra), është e çuditshme

dhe shumë tendencioze se si ka qenë e mundur që shifra 2606 të vlerësohet me poena maksimal.

**Përgjigje në pretendim (c) e AK:** Në të vetmin moment kur KV pranon diçka të vërtetë është kur thotë; *“Ringjallja e ngjarjeve historike...prezantuar nga OE1111...tejkalon objektivat e projektimit...”* dhe këtë e fut brenda një konteksti të vlerësimit negativ. Në fakt të gjithë duhet ta shohin këtë projekt jo thjesht si projektim, por si planifikim strategjik i integritetit të objektivave social-ekonomikë të të gjithë zonës përmes promovimit të vlerave historikë, përkujtesës së ngjarjes. OE1111 e ka trajtuar këtë vlerë në detaje, duke propozuar jo vetëm ndërtimin e një muzeu, por duke detajuar mënyrën e organizimit të vizitave në kompleksin memorial, teknikat vizuale por edhe të konservimit arkitektonik të kompleksit të shtepivë të fisit Jashari, pasurimin monumental të varrëzave të dëshmorëve, ndërtimin e Parkut të Paqes me të gjithë elementët, ndërtimin e Parkut Etno-Alb. OE1111 është e vërtetë që ka pasuruar dhe ka ndërtuar më shumë se sa ka parashikuar detyra e projektimit, por kjo është një vlerë për projektin dhe jo një mangësi. Për më tepër që nuk është kërkuar vetëkufizimi i propozimit vetëm në atë çfarë ka propozuar Autoriteti Kontraktues.

## **MUNGESA E NDËRLIDHJES SË FUNKSIONEVE BRENDË KOMPLEKSIT MEMORIAL**

Ndërkohë koncepti që ofron shifra 1111 është ambicioz, por edhe realist në të njëjtën kohë. Ai ndërton mbi potenciale reale që ka pesha historike e ngjarjeve të Prekazit dhe synon ta kthejë zonën me të vërtetë në një pol zhvillimi dhe pol të memories historike. Për këtë qëllim, shifra 1111 ka pasuruar konceptin e saj funksionet me të cilat duhet të pajiset zona për të qenë atraktive, për të tërhequr vizitorë dhe për të sjellë ekonomi në zonë.

Nëse shifra 2606 as nuk i trajton pothuajse funksionet e domosdoshme që duhet të plasohen në zonë për të rritur vlerat e vetë kompleksit memorial, shifra 1111 ka reflektuar më mirë detyrën e projektimit duke ndërtuar funksione të vizitueshme, atraktive e bashkëkohore.

Nëse shifra 2606 është tejet e kufizuar, pothuajse sipërfaqësore në propozimin e vet, shifra 1111 synon të fusë Prekazin në një hartë ndërkombëtare të vizitueshmërisë, dhe detyrimisht në hartën kombëtare të stacioneve patriotike e historike.

Shifra 2606 nuk jep zgjidhje të qëndrueshme për qarkullimin dhe nuk merr parasysh as problematikat e prezantuara nga detyra e projektimit, ndërkohë që Shifra 1111 ka propozuar një sistem të ri qarkullimi sidomos në zonën e kompleksit memorial ku ka dhe disa problematika të prezencës së objekteve që sfidojnë rëndësinë e kompleksit memorial

Shifra 2606 ka bërë një propozim shumë gjenerik mbi konservimin e kompleksit të kullave. Madje nuk shtjellon as teknikën dhe teknologjinë që propozon. Nga pikëpamja funksionale koncepti nuk trajton mënyrën se si do vizitohet kompleksi i kullave.

Krejt në të kundërtën e saj, shifra 1111 ka shtjelluar në detaje funksionet me të cilat do të pasurohet kompleksi memorial, objektet që do duhet të ndërtohen për të rritur vizitueshmërinë e kompleksit, aktivitetet që do duhet të organizohen aty, mënyrën se si do organizohet ceremoniali zyrtar por edhe ceremoniale të tjera, zonimin funksional për aksesoret që zona ka nevojë. Por mbi të gjitha, shifra 1111 ka përcaktuar qasjen dhe metodën se si do konservohet kompleksi i kullave duke e shtjelluar në detaje konservimin strukturor por edhe konservimin dhe zhvillimin e interierit të kompleksit për t’u vizituar. Edhe realizimi grafik i bërë nga shifra 1111 është shumë herë më i shtjelluar dhe ilustrues në krahasim me shifrën 2606.

Shifra 2606 po kaq sipërfaqësisht trajton edhe ish-Fabrikën e Municioneve duke reduktuar potencialin që kjo zonë ka. Aty sugjeron ndërtimin e një muzeu që çuditërisht do jenë shumë larg me kompleksin memorial me të cilin ky muze duhet të kishte lidhje direkte.

Ndërkohë që shifra 1111, ka propozuar një seri funksionesh si Panteoni, Salla e konferencave, hotele etj, që do bëjnë zonën një pol atraktiv edhe për evenimente ndërkombëtare duke shfrytëzuar në maksimum potencialin e atraksionit që ka kjo zonë.

Së fundmi, por jo nga rëndësia, shifra 2606 nuk inkorporon koncepte bashkëkohore të zhvillimit. Ajo veç e përmend zhvillimin e qëndrueshëm por nuk integron element esencialë që të ndikojnë në qëndrueshmërinë e zhvillimit. Përkundrazi shifra 1111 përveçse pasuron të gjithë zonën edhe më funksione mjedisore, sportive etj, synon të integrojë element të teknologjisë ndërtimore bashkëkohore që ndikojnë për mirë në mjedis dhe që bazohen në qasje senzitive ndaj koncepteve të zhvillimit të qëndrueshëm.

**Përgjigje në pretendimin (d) e AK:** Konstatimi është thellësisht i pavërtetë. OE1111 jo vetëm i ka trajtuar shtëpitë e kompleksit memorial bazuar në teknikat më strikte të konservimit, duke angazhuar ekspertizën më të mirë në mjedisin profesional, por i ka detajuar ato në raportin teknik duke dhënë referencat përkatëse për këto teknika. Në fakt në këtë moment, vihet në dyshim kapaciteti teknik për të vlerësuar propozimet për konservim pasi që vleresimi I koncepteve të master planit të konservimit është bere nga komisioni prej nje anthropology dhe 4 arkitekt te pa specializuar dhe te pa licencuar per konservim. Ndersa, per profesionist te veprimtarise se konservimit dhe restaurimit, me akte nenligjore te MKRS, ne menyre obligative kerkohet profesionisti I licencuar nga po kjo ministri. Kerkesa e profesionisteve te licencuar ne konservim, vlene edhe per profesionistet qe bejne vleresimin e projekteve te konservimit ne komisione.

Propozimi i OE1111 tjetërson mënyrën ekzistuese të mbrojtjes emergjente. Raporti teknik e sqaron që objektet çlirohen nga skela që pengon vëzhgimin e kompleksit. Propozimi zhvendos strukturën e kalimit lateralisht duke ruajtur objektet me një strukturë xhami teknologjik strukturor që lejon vëzhgimin e gjendjes së objekteve.

Në këtë moment duhet thënë që OE2606 sugjeron një kub xhami (që nuk dihet nëse është i realizueshëm pasi nuk e shtjellon nga pikpamja strukturore) që pengon vizualisht objektet monument historik. Kjo jo vetëm është në kundërshtim me praktikën e konservimit, por është kundraprofuksive pasi që shkon përkundra objektivit të vetë projektit.

OE1111 e ka sqaruar që përmes teknologjisë së qelqit strukturor por edhe integritit të teknologjisë LED, në rend të parë është shikueshmëria e vetë objektit, ndërsa në pjesën e mbrëmjes kur ka aktivitete ceremonial vetë ky LED ëall shërben për transmetimin psh të dokumentarëve hitsotikë mbi ngjarjen, apo mbi historinë e rezistencës në Kosovë.

Për më tepër OE1111 ka ndërtuar intinerar të vizitave brenda kompleksit të kullave dhe ka detajuar (i) teknikat e ndërhyrjeve strukturore (iii) rregullat e rrepta mbi konservimin arkitektonik të objektit ekzistues (iii) teknikat visive të dokumentimit dhe riprodhimit të ngjarjes. Madje pjesë e propozimit është edhe riprodhimi në dimension real i imazhit të pjestarëve në këtë ngjarje përmes teknikave të avancuara të museumeve më të njohura në botë sot.

Të gjitha këto propozim që në Raportin Teknik dhe në panele vizuale janë të detajuara as nuk janë vlerësuar nga KV. Përkundrazi është vlerësuar OE2606 megjithëse nuk thotë asgjë mbi parimet, teknikat dhe planin për konservim të objekteve



## VËREJTJE SHITESË RRETH KONCEPTIT ME SHIFRËN 2606


Në vijim janë paraqitur vërejtje shtesë rreth propozimit të kompanisë me shifrën 2606:

1.0 Te koncepti me shifrën 2606 janë vërejtur lëshime vijuese gjatë projektimit ;

1.1 Koncepti nuk parasheh një hapësirë që i dedikohet manifestimit të epopesë së UÇK-së e cila tradicionalisht zhvillohet me datë 5, 6 dhe 7 mars që kulmon me natën e zjarreve, e cila zakonisht tubon numër të madh të vizitorëve.

Për më tej propozimi nuk merr në konsideratë qasjen dhe parkingun e automjeteve zyrtare të cilat vizitojnë memorialin në ditë të caktuara të vitit dhe si i tillë konsiderohet që nuk i përmbushë as nevojat e as kërkesat e kësaj zone gjatë këtyre ditëve.

Pohimet e sipërme janë të ilustruara në mënyrë grafike në vijim:



1.2 Koncepti planifikon një rrugë të re të shtruar mbi shtëpitë ekzistuese të pjesëtareve të familjes së gjerë Jashari. Kjo nënkupton që realizimi i kësaj rruge do të rezultojë në shpronësimin dhe rrënimin e këtyre shtëpive e që mundet të shkaktojë pakënaqësi tek banorët e zonës dhe gjithashtu të ngrit koston e realizimit të këtij projekti.





**Përgjigje në pretendimin (f) e AK:** Ky pretendim është një lloj kontradikioni në vetvete. Kërkesa është disiplinimi i qarkullimit në zonë në mënyrë që të evidentohen vlerat, të lehtësohet vizitueshmëria dhe të realizohen eventet. Këtë gjë e ka bërë më së miri propozimi i OE1111 duke shmangur qarkullimin në zonë, pra duke shmangur trafikun dhe duke disiplinuar parkimin. Në periferinë e kompleksit është dhënë alternativa e parkimit për këtë qëllim. Nuk ka princip planifikimi, projektimi, konservimi që ta përcaktojë këtë gjë si dëmtim të vlerave. Përkundrazi, këto aksesore i japin mundësi njerëzve ta vizitojnë kompleksin pa cënuar vlerat e tij. Është absurd të mendosh që një sasi të konsideruar vizitorësh, populli, autoritetesh apo të ftuar nuk u duhet dhënë mundësia e të parkuarit në periferi të kompleksit (dhe jashtë tij praktikisht). E kundërta ndodh sot. Sot kompleksi pershkohet nga një rrugë që duhet të ishte transit. Sot makinat parkojnë anash rrugëve në mes të kompleksit duke u bërë edhe burim aksidenti. Në vënd që të vlerësojë këtë zhvendosje positive, KV në mënyrë krejt jo realiste pretendon që njerëzit do shfaqen në zonë pa vrarë mendjen se me c'mjet transoirti do vijjnë. Nga ana tjetër është shqetësuese që KV-së nu ki bën përshtypje propozimi i OE2606 i cili për të propozuar një rrugë kalimi planifikon rrenimin e disa shtepive të fisit Jashari që duhet të ishin pjesë e kompleksit.

1.3 Koncepti në vënd se të lartësojë sakrificën e veçantë anëtarëve të familjes Jashari, të cilët ranë heroikisht në muajin Mars të vitit 1998, duke theksuar varrezat e tyre, vendosja apo mbajtja e varrezave të fshatit në mes të memorialit, zbehë praninë e varrezave të dëshmorëve. Kështu që më me pozitën e e saj qendrore më shumë janë të theksuara varrezat e fshatit se sa varrezat e dëshmorëve. Kjo theksohet edhe me tej me orientimin e amfiteatrit drejtë varrezave të fshatit në vënd që amfiteatri të jetë i orientuar drejt varrezave të dëshmorëve me skenën për manifestimin vjetor, e cila mungon në projektin ideor, i cili mund të vërehet edhe në imazhin vijues:



**Përgjigje në pretendimin (g) e AK:** Vlerësimi është thjesht i pavërtetë pasi transformon qëllimshëm, duke e përgjithësuar, propozimin. Zonat e destinuar si peisazh nuk janë çënuar nga ndërtime. Pasurimi më funksione apo me aksesore që kompleksi i ka nevojë nuk janë farë në kundërshtim me principet e konservimit. Së pari vërejtja nuk referon asnjë 'kartë' apo 'konventë' me të cilin bie ndesh propozimi. Kjo tregon sërish tendenciozitetin dhe mungesën e profesionalizmit të vlerësimit. Së dyti, vërejtja nuk referon se për ç'ndërhyrje e ka fjalën. Pra sipas KV zona nuk duhet të ketë një amfiteatër ku të zhvillohen ceremonitë përkujtimore? Pra zona nuk duhet të ketë muze? Zona nuk duhet të kenë një park përkujtimor ku të kujtohen ngjarjet historike? Zona nuk duhet të ketë një Park Historik ku trajtohen në mënyrë të organizuar vlerat historike të popullit shqiptar? Pra zona nuk duhet të ketë një Park panteon ku të promovohen vlerat paqësore të popullit shqiptar? Pra zona nuk duhet të ketë Shtegun e Meditimit dhe Reflektimit që promovon vlerat e rezistencës së zonës së Prekazit? Asnjë nga këto ndërhyrje të propozuara nuk çënojnë në asnjë moment t'ë vetëm zonat pesiazhike dhe nuk janë në kundërshtim më principet e mbrojtjes së zonave me vlera natyrore apo monumentale. KV shpik principe e kritere nga njëra anë dhe mbyll sytë kur principet e kriteret shkelen nga ana tjetër. OE1111 në propozimin e vet nuk ka zhvendosur asnjë aks monumentaliteti (shpikje e KV), pasi kompleksi ekzistues nuk ka diçka të tillë. Propozimi ka ndërtuar mbi një situatë ekzistuese dhe synon t'i integrojë dhe t'i nxjerrë në pah.

Duke zgjeruar zonën pedonale propozimi ka shtuar vlerën e kompleksit. Pastaj propozimi ka shtuar funksione që ndihmojnë kompleksin në rritjen e vizitueshmërisë së tij. Propozimi ka shtuar aksesore që e bëjnë kompleksin më atraktiv. Mungesa e aksit vjen nga fakti që elementët ekzistues nuk janë vendosur në një të tillë. Varreza e dëshmorëve, kompleksi i shtëpive janë elementë që merren në konsideratë ashtu sic janë. E rëndësishme është që elementët e propozuara të jenë në harmoni funksionale dhe arkitektonike.

Nga ana tjetër në vlerësimin e propozimit të OE2606 KV bën një gafë ekstreme. Të konsiderosh aks monumentaliteti faktin që përballë varrëzave të dëshmorëve janë varrëza civile është ekstremisht në kundërshtim me ruajtjen e promovimin e vlerave monumentale. Nuk është parë ndonjëherë që varrezat civile të futen brenda një kompleksi monumental të varrëzave të dëshmorëve. Do mjaftonte kaq që propozimi i OE2606 të vlerësohej negativisht. Përkundrazi, KV mbyll sytë para kësaj gave dhe shpik kritere për vlerësimin e operatorëve të tjerë

Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, Organit Shqyrtues të Prokurimit i propozojmë që të marrë këtë:

### **VENDIM**

**APROVOHET** si e bazuar Ankesa e paraqitur nga grupi i OE me shifrën 1111.

**OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që lëndën ta kthejë në Rivlerësim të ofertave dhe pas rivlerësimit shifra 1111 të vlerësohet në mënyrë të drejtë, ndërsa OE me shifrën 2606 dhe OE Polis të shpallen administrativisht të papërgjegjshëm.

## **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

**Dëmet materiale që shkaktohen janë të konsiderueshme si në fushën financiare, ashtu edhe në fitime të munguara.**

## **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrë të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Neni 55.16 i Rregullores 001/2022

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Grupi i Operatorëve Ekonomik Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., Tecnoengineering SRL, Daniele Lauria, Studio Lauria Network, Alb-Architect SH.P.K., në 20.09.2023 ka dorëzuar ofertën e saj për tenderin me titull: **“Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial ‘Adem Jashari’, në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës”**, me numër anonim katërshifror [1111], i cili pas hapjes së Dokumentacionit teknik – projektit ideor, është vlerësuar me 32.64%, renditur i dyti me më së shumti pikë.

Pas kërkesës për qasje më 04.12.2023, ne kemi vërejtur tri lloje të shkeljeve:

1. Shkeljet administrative – procedurale;
2. Shkeljet profesionale;
3. Pretendime tjera

Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial ‘Adem Jashari’, në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës gjatë qasjes në dokumente nga ana e jone (Shifra 1111) është vërejtur se ka shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik, Rregullave 001/2022 dhe Udhezuesit 001/2023 pasi që në qasje kemi kuptuar:

### Me poshtë gjeni shkeljet administrative – procedurale:

#### Pretendimi 1.

- Operatori Ekonomik Polis / ka bërë shkelje të Rregullores 001/2022, përkatësisht neni 55.22 Informatat mbi numrin serik, datën, kohën dhe identitetin e zyrtarit pranues si dhe **numrin katërshifror** të zgjedhur nga pjesëmarrësi, për propozimet e pranuar me kohë, do të regjistrohen në formularin standard të aprovuar nga KRPP, “Procesverbali i dorëzimit të tenderit” pasi që ka zbuluar identitetin e vet, dhe Hapja dhe vlerësimi i projekteve **55.24 Pasi që identiteti i pjesëmarrësve nuk do t’i shpaloset jurisë**, zyrtari përgjegjës i prokurimit do t’i hap zarfet e pranuar me kohë dhe do t’i ndajë zarfet që përmbajnë “projektet ideore” nga ato që përmbajnë “dokumentacionin e kandidatit”. Po ashtu ka shkelur LPP konkretisht nenin 80 paragrafi 2 të LPP-së theksohet tutje: 2. Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. **Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.**

#### Pretendimi 2.

- OE Polis – sipas Formularit të Dosjes së Tenderit (FDT) ka bërë shkelje të procedurave administrative në LPP, pasi që ka vepruar në kundërshtim: 23.1 - Vendi: Projekti ideor duhet të dorëzohet fizikisht në Zyrën 020 në MKRS (e ndarë në një Original dhe dy kopje) ashtu siç janë të përcaktuar me LPP dhe rregulloret tjera në fuqi. **Ndërsa dokumentacioni tjetër duhet të bashkangjitet në formatin elektronik.** Bazuar në dokumentacionin në qasje në dokumente zyrtare, kemi vërejtur se shifra OE POLIS nuk ka bashkangjitur ofertën në menyre elektronike.

#### Pretendimi 3.

- Shifra 2606 – sipas procesverbalit të takimeve (takimit 1) theksohet nga ana e jurisë profesionale se ofertat e kesaj shifre janë të gjitha në një pako. Gjate vizites tone në Sallen e Vlerësimit të ofertave kemi vërejtur se kjo shifer i ka të gjitha zarfet e hapura dhe perbenë shkelje prapë të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregulloreve pasi që Oferta në Konkursin e Projektimit ishte: 1 Original dhe 2 Kopje (Dy kopjet duhet të jenë të mbyllura dhe hapen vetëm në procese gjyqësore ose me vendime të OSHP-së). Baza: Neni 55.15 dhe Neni 55.16 Zarfi që përmban Dokumentacionin e Kandidatit do të përmbajë: a. ekzemplarin origjinal të të gjitha kërkesave tjera, (emri, adresa, përshtatshmëria, kërkesat ekonomike/financiare dhe teknike, dhe nëse është e zbatueshme, oferta financiare), e shënuar si “Original”; dhe b.

numrin e kërkuar të kopjeve të dokumentacionit të kandidatit”. **Pjesëmarrësi do ta mbyllë ekzemplarin origjinal të dokumentacionit të kandidatit dhe secilën kopje në zarfe të posaçëm dhe në faqen e përparmë të secilit zarf do të: a. Shënojë qartë si “Origjinali – Dokumentacioni i kandidatit” ose “Kopje – Dokumentacioni i Kandidatit”; b. Shënojë numrin e Prokurimit sikurse ceket në dosjen e konkursit të projektimit; c. Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit; dhe d. Paralajmërimi “mos e hapni me projektin Ideor”. Po ashtu, kjo shklje perbene edhe shkleje te nenit 23.1 të FDT-së ku është cekur: 23.1 - Vendi: Projekti ideor duhet të dorëzohet fizikisht në Zyrën 020 në MKRS (e ndarë në një Original dhe dy kopje)**

KODI 1 (të emërtuar nga anëtarët e Komisionit, pasi që në këtë rast O.E. ka zbuluar identitetin në të gjithë dokumentacionin e dorëzuar) u konstatua se O.E. ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues të gjitha produktet sipas kërkesës - C të dosjes se tenderit, origjinal dhe dy kopje, dhe atë:

- Produkti 1: Raportet teknike të projektit - në format A4 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Panelet ekspozuese - gjithsej gjashtë (6), në format A0 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Video animacioni - USB e lexueshme.

KODI 2606 (O.E. ka bashkangjitur në një pako të gjithë dokumentacionin, origjinalin dhe 2 kopje) u konstatua se O.E. ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues të gjitha produktet sipas kërkesës - C të dosjes se tenderit, origjinal dhe dy kopje, dhe atë:

- Produkti 1: Raportet teknike të projektit - në format A4 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Panelet ekspozuese - gjithsej gjashtë (6), në format A0 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Video animacioni - CD e lexueshme.

KODI 1111 u konstatua se O.E. ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues të gjitha produktet sipas kërkesës - C të dosjes se tenderit, origjinal dhe dy kopje, dhe atë:

- Produkti 1: Raportet teknike të projektit - në format A4 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Panelet ekspozuese - gjithsej gjashtë (6), në format A0 dhe në përpjesë adekuate leximi.
- Produkti 2: Video animacioni - USB e lexueshme.

Faqe 2 nga 3

Numri i Prokurimit: 207-23-5283-2-1-1 - Titulli

Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari'

#### **Pretendimi 4.**

- Shifra 2606 – sipas Formularit të Dosjes se Tenderit (FDT) ka bërë shkelje të procedurave administrative ne LPP, pasi qe ka vepruar në kundërshtim: 23.1 - Vendi: Projekti ideor duhet të dorëzohet fizikisht në Zyrën 020 në MKRS (e ndarë në një Original dhe dy kopje) ashtu siç janë të përcaktuar me LPP dhe rregulloret tjera në fuqi. **Ndërsa dokumentacioni tjetër duhet të bashkangjitet në formatin elektronik.** Bazuar në dokumentacionin në qasje ne dokumente zyrtare, kemi vërejtur se shifra 2606 nuk ka bashkangjitur oferten ne menyre elektronike.

Po ashtu, Koment për anetaret e komisionit apo Drejtorin e Prokurimit kur vlerësohet Kërkesa për rishqyrtim:

- Shifra 1111 / duke u bazuar në Procesverbalin e takimit te pare, theksohet që ka dorezuar dokumentacionet sipas kërkesës.



- Shifra 1111 / duke u bazuar në nenin 23.1 të Formularit të Dosjes së Tenderit – ka paraqitur Oferten në formën elektronike ashtu siç është kërkuar në formular.

Kurse, dy Operatorët Ekonomik të paraqitur me lartë edhe si kanë plotësuar kriteret sic duhet edhe nuk kanë ofertuar në formatin e kërkuar nga vet Autoriteti Kontraktues.

Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	Vendi: <b>Projekti ideor duhet të dorëzohet fizikisht në Zyrën 020 në MKRS (e ndarë në një Original dhe dy kopje) ashtu siç janë të përcaktuar me LPP dhe rregulloret tjera në fuqi. Ndërsa dokumentacioni tjetër duhet të bashkëngjitet në formatin elektronik.</b>
--	--

Jemi të habitur se si AK dhe komisioni ka vlersuar dy OE të cilët de fakto nuk kanë ofertuar fare në e-prokurim (dëshmi foto të bashkëngjitur më poshtë), andaj kërkojmë nga AK të pergjigjet në këtë pyetje që sipas kërkesës së tyre në DT sa kompani kanë ofertuar në mënyrë elektronike, të kërkohej nga KRPP interpretim se si juridikisht keni bërë një leshim të tillë.

## PËRMBLEDHJA E PROKURIMIT

### INFORMATA BAZE PËR PROKURIM

<b>Autoriteti kontraktues:</b>	MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK,
<b>Lënda e prokurimit:</b>	Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës
<b>Numri i prokurimit</b>	207-23-5283-2-1-1
<b>Afati për dorëzimin e ofertave:</b>	20.09.2023 02:00
<b>Vlera e parashikuar:</b>	3 000 000,00
<b>FPF Kodi:</b>	74223000-8 Organizimi i konkurseve arkitektonike të projektimit
<b>Lloji i kontratës:</b>	2 Shërbime
<b>Lloji i marrëveshjes kornizë:</b>	Nema
<b>Lloji i procedurës:</b>	1 Procedurë e hapur
<b>Numri total i ofertave:</b>	1
<b>Numri total i kontratave / marrëveshjet kornizë:</b>	0

### NJOFTIMET

Numri i referencës së publikimit	Tipit të dokumentit	Data e dërgimit	Data e publikimit
<a href="#">2023/207-23-5283-2-1-1/RO5-0012726</a>	B05 Njoftim për Kontrat	24.05.2023	25.05.2023

Ofertuesi	Prokurimi	Autoriteti kontraktues	Lënda e ofertës	Kodi	Afati për dorëzimin e ofertave	Data e pranimit të aplikacioneve	Statusi i ofertës
Grup i Operatorëve Ekonomikë Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë Insi SH.P.K. TECNOENGINEERING SRL, DANIE LAURIA, STUDIO LAURIA NETWORK ALB - Architect SH.P.K.	Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës	MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK	207-23-5283-2-1-1	0918	20.09.2023 14:00	20.09.2023 11:56	Në vlerësim

Sipas përmbledhjes së prokurimit (bashkëngjitur foto e parë si dëshmi), nënkupton se vetëm një operator ekonomik ka aplikuar online, dhe bazuar në dëshminë e dytë që na tregon tabelën e tenderëve ku kemi aplikuar, nënkuptohet qartë se jemi në të vetmit Grupi i Operatorëve Ekonomik që kemi dorëzuar ofertën përmes sistemit elektronik, siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Pretendimi 5.

#### **Me poshtë gjeni shkeljet apo devijimet profesionale:**

Propozimi i shifrës [2606] është i mbivlerësuar vis a vis propozimit të shifrës [1111], ndërkohë që ky i fundit është thellësisht i nënvleftësuar për tërësinë e propozimeve që ka bërë Komisioni Vlerësues.

Në vijim janë të paraqitura disa nga vërejtjet tonë rreth vlerësimit të Projektimit të Peizazhit Kulturor "Kompleksi Memorial Adem Jashari" nga kompania projektuese me shifrën 2606:

#### **MUNGESA E VIZIONIT, QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE**

Shifra 2606 ka dhënë një propozim të përgjithshëm, sipërfaqësor dhe pa vlera të pashtjelluar. Vetë koncepti është i pa trajtuar dhe i pa artikuluar në dokumentin e propozimit.

Koncepti i propozuar nga shifra 2606 është i mangët, steril dhe thjesht një përshkrim sipërfaqësor. Ai nuk është shtjelluar as minimalisht sipas një strukturë të kërkuar pa arritur të ndërtojë VIZION, pa përcaktuar QËLLIME dhe OBJEKTIVA për zhvillim.

Ndërkohë propozimi i shifrës 1111 është i shtjelluar në detaje duke mirë përcaktuar Vizionin për zhvillim, Qëllimet dhe Objektivat specifike me instrumentet përmes së cilëve të realizohen këto objektiva.

Përkundër që është kërkuar me detyrë projektuese, kompleksit memorial të propozuar nga shifra 2606, i mungon të kuptuarit e masterplanit i mungojnë VIZIONI, QËLLIMET dhe OBJEKTIVAT, si dhe më shumë i mungojnë edhe parimet e kërkuara me detyrë projektuese për projektim, kështu që vlerësimi i tij me poena maksimal është i çuditshëm kur merren për bazë gjithë këto mungesa.

#### **MUNGESA E NJË PLANIFIKIMI SPECIFIK KUNDREJTË KONTEKSTIT TË LOKACIONIT, NGJARJEVE HISTORIKE DHE DETYRËS PROJEKTUESE**

Metodologjia e shifrës 2606 është një tekst gjenerik dhe shumë i përgjithshëm, dhe si i tillë mund të aplikohet për çfarëdo lloj iniciative apo projekti për ndonjë lokacion ose detyrë projektuese tjetër, pasi që nuk artikulon qasjen konkrete në realizimin e këtij projekti shumë specifik.

Ndërkohë që shifra 1111 ka shtjelluar në detaje metodologjinë dhe qasjen në të cilën do bazohet dhe referencat në dokumentet zyrtare dhe metodologjinë zyrtare të planifikimit për të arritur objektivat e vëna nga detyra e projektimit.

Po kështu koncepti kuratorial i shifrës 2606 është i vakët, i përgjithshëm dhe nuk ndërton mbi vlerat e zonës. Ai e sheh projektin në mënyrë të ngushtë brenda 'infrastrukturës' ekzistuese pa ndërtuar në realitet një narrativë të qenësishme për të gjithë kompleksin dhe zonën. Ky koncept është një riprodhim i varfëruar i detyrës së projektimit dhe nuk lejon të ndërtohet diçka inspiruese në këtë projekt.

Nëse shihet si përmbajtje e përgjithshme shifra 2606 lirshëm mund të thuhet se ka një trajtim minimal shkollor të kompleksit memorial, deri sa shifra 1111 heroizmin e familjes i cili është unik dhe i vetëm në botë si pjesë të kompleksit memorial e shef si gurthemel për intervenimin e NATO-s dhe rezolutën 244 rrjedhimisht lirinë dhe paqen në Kosovë që janë rezultat i sakrificës dhe heroizmit të familjes Jashari, andaj trajtimi i kompleksit memorial si vlerë botërore me synim në UNESCO (pasi që UNESCO ka filluar ti vendos nën mbrojtje edhe komplekset memorialë), në krahasim me trajtimin e shifrës 2606 si vlerë e rëndomtë lokale fuqishëm flasim për dy vizione dhe koncepte të ndryshme e ne jemi të bindur se është në interes të Kosovës por edhe gjithë shqiptarëve që kompleksi memorial të trajtohet në vlerën e vet reale, si vlerë botërore dhe lirshëm mund të themi se nuk ka rast të ngjashëm në histori të njerëzimit, është e çuditshme dhe jonormale që këtë vlerë kombëtare në

nivel lokal.

Jemi të bindur se shqiptarët për arsye të vlerave të familjes Jashari dhe deri më tani e kanë vizituar dhe do të vazhdojnë ta vizitojnë këtë memorial, por vizioni qëllimor dhe objektivat e shifrës 1111 kanë qene që sakrificën dhe heroizmin e familjes Jashari ta vendosin me përmbajtje arkitektonike dhe përmbajtje të tjera ashtu që të nxite vizitat me numër të madh të vizitorëve të huaj, duke shndërruar këtë kompleks në qendër botërore të sakrificës heroizmit dhe paqes, për çka nga shifra 1111 është vendosur edhe panteoni i nobelistëve të paqes si simbol i sakrificës së familjes Jashari për paqe i intervenimit të NATO – s për paqe dhe rezolutës 1244 për paqe globale, por të njëjtën kohë duke vendosur një panteon i cili do të nxitë ardhjen e nobelistëve të cilat janë gjallë, të institucioneve me çmim Nobel, të organizimit të konferencave dhe ngjarjeve të nivelit botëror për paqe por edhe nivelit kombëtar e rajonal edhe për më shumë nxitjen e shumë vizitorëve të huaj, paqe më shumë është te panteoni i paqes është planifikuar edhe për nobelistët e ri që do të shpallen në ta ardhmen, ku edhe atyre do të ju ngritet shtatorja me ç’rast kompleksin memorial do e mbajmë gjallë me organizime dhe aktivitete të ndryshme.

Me detyrë projektuese është kërkuar ringjallja e ngjarjes historike të 5,6 dhe 7 marsit, nëse shihet koncepti dhe metodologjia e shifrës 2606 asnjë trajtim serioz që bënë një ringjallje apo rikujtim të kësaj ngjarje nuk është trajtuar, përderisa tek shifra 1111 janë trajtuar 59 shtatore të nobelistëve të paqes ashtu siç i ka quajtur Bernard Kushner te cilët do të jenë punuar nga materiali i gomës që është 98 – 99% afër pamjeve reale të dëshmorëve ose për shkak të qëndrueshmërisë më të gjatë nga materiali i bronzit me ngjyrë i cili është afër 95% i dukjes reale të dëshmorëve.

Vendosja e tyre nëpër kulla dhe shtëpi është një përmbajtje kryesore që do ta ringjallë komplet ngjarjen me 5,6 dhe 7 marsit edhe vendosja e tyre nëpër shtëpitë origjinale të tyre do ti mundësoj vizitorit edhe emocion edhe një përjetim të veçantë ngjarjes dhe rinjohje të komplet 59 dëshmorëve dhe kontributit dhe sakrificës të burrave dhe grave në këtë ngjarje.

Kërkesa për organizim të dinjitetshëm dhe institucional të ceremonisë së 5,6 dhe 7 marsit në metodologjinë e shifrës 2606 është i mangët, jofunksional dhe joadekuat.

Mungesa e parkingut në zonë, mungesa e një ceremonie serioze të “Natës së Zjarreve” përveç zëvendësimit me drita në tri kullat të cilat edhe ashtu nuk do të kenë ndonjë risi sepse do të jenë në mënyrë të vazhdueshme të ndezura.

Për më tej, metodologjia e propozuar për konservimin e ndërtesa është shumë e vobektë dhe nuk është e qartë çfarë ndërhyrje janë propozuar. Për dallim nga propozimi me shifrën 1111, propozimi me shifrën 2606 nuk ka dorëzuar një metodologji të qartë të konservimit, konceptin kuratorial apo detaje të konstruksionit të qelqit mbrojtjes të kullave të familjeve të Adem dhe Hamëz Jasharit.

### **MUNGESA E DIVERSITETIT TË FUNKSIONEVE DHE HAPËSIRAVE ADEKUATE PËRCJELLËSE KUNDREJTË KONTEKSTIT TË LOKACIONIT, NGJARJEVE HISTORIKE DHE DETYRËS PROJEKTUESE**

Përkundrazi, shifra 1111 e ka paraparë konceptin kuratorial si një zhvillim i të gjithë zonës duke e trajtuar si një organizëm që do funksionojë me të gjithë diversitetin e funksioneve të të gjithë elementëve në zonë duke integruar aspekte të ndryshme të zhvillimit, si aspekti i trashëgimisë historike dhe aspekti i socio-ekonomik i zhvillimit.

Koncepti i ofruar nga shifra 2606 është i varfër në funksione, modest në objektiva dhe për rrjedhojë nuk do sjellë asnjë zhvillim të qenësishëm në zonën e Prekazit.

Amfiteatri i vendosur me fokus ka varrezat e reja të fshatit ( të cilat edhe ashtu nuk e kanë vendin në kompleksin memorial, “Në asnjë rast në botë nuk e gjen një rast të tillë”), për më shumë pozita e amfiteatrit me shpinë të kthyer nga varrezat e familjes Jashari është zgjidhja më joracionale dhe e papranueshme, për më shumë mundë të quhet edhe skandaloze.

Në krahasim me konceptin e shifrës 1111, vërtetë është për të u habitur se si ka mundësi të vlerësohet me kaq shumë pikë shifra 2606. Kjo qasje e vlerësimit në mënyrë të qartë lenë për të nënkuptuar se është me tendencë dhe qëllim favorizimi jomeritor të konceptit të mangët të shifrës 2606, për shkak se:

1. Kthimi i ish-fabrikës së municionit me një sipërfaqe prej 3500m<sup>2</sup> në muze nacional të rezistencës është zgjidhja më joracionale dhe jofunksionale në raport me kërkesat e detyrës

- projektuese, ju përkujtojmë se është kërkuar hapësire për vendosjen e përmbajtjeve si konferenca, workshope, shfaqje, koncerte, etj, e jo vetëm hapësirë muzeale. Vendosja e muzeut nacional në një distancë prej 3km nga kullat e Jasharajve nga shifra 2606 vërtetë është e çuditshme, joracionale dhe jofunksionale (vetëm paramendoni dikë që viziton kompleksin memorial i duhet të përshkojë një rrugëtim deri në 3km për të arritur në muze), derisa shifra 1111 ish fabrikën e municionit e ka planifikuar ta shndërroj nga një pikë ku është prodhuar municion i cili është përdorur për dhunë dhe terror ndaj shqiptarëve në një sallë ku mundë të organizohen konferenca, workshope, shfaqje, koncerte të nivelit rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar e sidomos simbolika e kthimit të këtij vendi në një vatër ku përkujtohet historia me fotografi dhe mundësi vizuale, mirëpo që promovon paqe botërore është në funksion të vizionit që shifra 1111 ka për vendosjen e kompleksit memorial nga niveli kombëtar në nivel botëror duke e planifikuar muzeun në hapësirat afër kullave të Jasharajve dhe duke krijuar funksionalitet dhe racionalitet, është e çuditshme dhe shumë tendencioze se si ka qenë e mundur që shifra 2606 të vlerësohet me poena maksimal.
2. Trajtimi i mangët i hapësirave sportive nga shifra 2606 dhe trajtimi si një qendër ku do të zhvillohen gara vendore dhe ndërkombëtare në disa sporte nga shifra 1111 edhe këto flasin për koncepte dhe vizione të ndryshme, njëra e shifrës 1111 e cila synon ta mbajë gjallë kompleksin memorial edhe me ngjarje të tilla ndërsa e shifrës 2606 e cila nuk ka asnjë përmbajtje, është e çuditshme dhe shumë tendencioze se si ka qenë e mundur që shifra 2606 të vlerësohet me poena maksimal.
  3. Trajtimi i tri zonave për banim të qëndrueshëm nga shifra 2606 nuk mundë të konsiderohet as si një detyrë e thjeshtë shkollore, përderisa shifra 1111 i trajton tri zona të banimit me të gjitha përmbajtjet në funksion të kompleksit memorial të cilat përpos aspektit funksional ofrojnë edhe komoditet edhe kapacitete për pranimin e vizitorëve në kompleks memorial, është e çuditshme dhe shumë tendencioze se si ka qenë e mundur që shifra 2606 të vlerësohet me poena maksimal.
  4. Derisa në detyrë projektuese është kërkuar që të gjitha shtëpitë të rëndësisë historike të zonës propozohen masa konservimi restaurimi dhe mbrojtje është e çuditshme se shifra 2606 as nuk i trajton në përmbajtjen e plotë për më shumë mbi disa shtëpi projektin edhe rrugë që është në kundërshtim të plotë me kërkesat e detyrës projektuese për të konsoliduar dhe mbrojtur shtëpitë, në krahasim me shifrën 1111 e cila të gjitha shtëpitë me vlera historike dhe të propozuara për mbrojtje ju bënë një trajtim të veçantë me masa një nga një, andaj vërtetë është e çuditshme se si është e mundur të bëhet një vlerësim i tillë i shifrës 2606 kur janë në disharmoni të plotë me kërkesën e detyrës projektuese.
  5. Te koncepti i ringjalljes të ngjarjeve historike në zonë derisa shifra 2606 nuk e trajton fare, shifra 1111 ka planifikuar në shtrirje prej 30ha parkun etnoalb i cili ringjallë historinë e shqiptarëve, historinë e Kosovës dhe historinë e Prekazit, duke lëvizur qytet për qytet me një simbol të qytetit shqiptar dhe me anë të argumentit reality AR dhe me QR Code merr informacione të sinkronizuara mbi ngjarjet historike duke bërë edhe vizitorin vendor edhe ndërkombëtar të informuar me historinë e shqiptarëve, Kosovës dhe Prekazit dhe ngjarjeve nëpër vite, në të njëjtën kohë duke ofruar një ambient me mobilieri urbane të përshtatshme për shëtitje dhe rekreacion, duke pasur edhe përmbajtje shërbyese (Kafiteri, ëmbëltore e Restorante të kufizuara në numra), është e çuditshme dhe shumë tendencioze se si ka qenë e mundur që shifra 2606 të vlerësohet me poena maksimal.

### **MUNGESA E NDËRLIDHJES SË FUNKSIONEVE BRENDË KOMPLEKSIT MEMORIAL**

Ndërkohë koncepti që ofron shifra 1111 është ambicioz, por edhe realist në të njëjtën kohë. Ai ndërton mbi potenciale reale që ka pesha historike e ngjarjeve të Prekazit dhe synon ta kthejë zonën me të vërtetë në një pol zhvillimi dhe pol të memories historike. Për këtë qëllim, shifra 1111 ka pasuruar konceptin e saj funksionet me të cilat duhet të pajiset zona për të qenë atraktive, për të tërhequr vizitorë dhe për të sjellë ekonomi në zonë.

Nëse shifra 2606 as nuk i trajton pothuajse funksionet e domosdoshme që duhet të plasohen në zonë për të rritur vlerat e vetë kompleksit memorial, shifra 1111 ka reflektuar më mirë detyrën e projektimit duke ndërtuar funksione të vizitueshme, atraktive e bashkëkohore.

Nëse shifra 2606 është tejet e kufizuar, pothuajse sipërfaqësore në propozimin e vet, shifra 1111 synon të fusë Prekazin në një hartë ndërkombëtare të vizitueshmërisë, dhe detyrimisht në hartën

kombëtare të stacioneve patriotike e historike.

Shifra 2606 nuk jep zgjidhje të qëndrueshme për qarkullimin dhe nuk merr parasysh as problematikat e prezantuara nga detyra e projektimit, ndërkohë që Shifra 1111 ka propozuar një sistem të ri qarkullimi sidomos në zonën e kompleksit memorial ku ka dhe disa problematika të prezencës së objekteve që sfidojnë rëndësinë e kompleksit memorial

Shifra 2606 ka bërë një propozim shume gjenerik mbi konservimin e kompleksit të kullave. Madje nuk shtjellon as teknikën dhe teknologjinë që propozon. Nga pikëpamja funksionale koncepti nuk trajton mënyrën se si do vizitohet kompleksi i kullave.

Krejt në të kundërtën e saj, shifra 1111 ka shtjelluar në detaje funksionet me të cilat do të pasurohet kompleksi memorial, objektet që do duhet të ndërtohen për të rritur vizitueshmërinë e kompleksit, aktivitetet që do duhet të organizohen aty, mënyrën se si do organizohet ceremoniali zyrtar por edhe ceremoniale të tjera, zonimin funksional për aksesoret që zona ka nevojë. Por mbi të gjitha, shifra 1111 ka përcaktuar qasjen dhe metodën se si do konservohet kompleksi i kullave duke e shtjelluar në detaje konservimin strukturor por edhe konservimin dhe zhvillimin e interierit të kompleksit për t'u vizituar. Edhe realizimi grafik i bërë nga shifra 1111 është shumë herë më i shtjelluar dhe ilustrues në krahasim me shifrën 2606.

Shifra 2606 po kaq sipërfaqësisht trajton edhe ish-Fabrikën e Municioneve duke reduktuar potencialin që kjo zonë ka. Aty sugjeron ndërtimin e një muzeu që çuditërisht do jenë shumë larg me kompleksin memorial me të cilin ky muze duhet të kishte lidhje direkte.

Ndërkohë që shifra 1111, ka propozuar një seri funksionesh si Panteoni, Salla e konferencave, hotele etj, që do bëjnë zonën një pol atraktiv edhe për evenimente ndërkombëtare duke shfrytëzuar në maksimum potencialin e atraksionit që ka kjo zonë.

Së fundmi, por jo nga rëndësia, shifra 2606 nuk inkorporon koncepte bashkëkohore të zhvillimit. Ajo veç e përmend zhvillimin e qëndrueshëm por nuk integron element esencialë që të ndikojnë në qëndrueshmërinë e zhvillimit. Përkundrazi shifra 1111 përveçse pasuron të gjithë zonën edhe më funksione mjedisore, sportive etj, synon të integrojë element të teknologjisë ndërtimore bashkëkohore që ndikojnë për mirë në mjedis dhe që bazohen në qasje senzitive ndaj koncepteve të zhvillimit të qëndrueshëm.

## **VËREJTJE SHITESË RRETH KONCEPTIT ME SHIFRËN 2026**

Në vijim janë paraqitur vërejtje shitesë rreth propozimit të kompanisë me shifrën 2606:


1.0 Te koncepti me shifrën 2606 janë vërejtur lëshime vijuese gjatë projektimit ;

1.1 Koncepti nuk parasheh një hapësirë që i dedikohet manifestimit të epopesë së UÇK-së e cila tradicionalisht zhvillohet me datë 5, 6 dhe 7 mars që kulmon me natën e zjarreve, e cila zakonisht tubon numër të madh të vizitorëve.


Për më tej propozimi nuk merr në konsideratë qasjen dhe parkingun e automjeteve zyrtare të cilat vizitojnë memorialin në ditë të caktuara të vitit dhe si i tillë konsiderohet që nuk i përmbushë as nevojat e as kërkesat e kësaj zone gjatë këtyre ditëve.

Pohimet e sipërme janë të ilustruara në mënyrë grafike në vijim:





1.2 Koncepti planifikon një rrugë të re të shtruar mbi shtëpitë ekzistuese të pjesëtareve të familjes së gjerë Jashari. Kjo nënkupton që realizimi i kësaj rruge do të rezultojë në shpronësimin dhe rrënimin e këtyre shtëpive e që mundet të shkaktojë pakënaqësi tek banorët e zonës dhe gjithashtu të ngrit koston e realizimit të këtij projekti.



1.3 Koncepti në vend se të lartësojë sakrificën e veçantë anëtarëve të familjes Jashari, të cilët ranë heroikisht në muajin Mars të vitit 1998, duke theksuar varrezat e tyre, vendosja apo mbajtja e varrezave të fshatit në mes të memorialit, zbehë praninë e varrezave të dëshmorëve. Kështu që më me pozitën e e saj qendrore më shumë janë të theksuara varrezat e fshatit se sa varrezat e dëshmorëve. Kjo theksohet edhe me tej me orientimin e amfiteatrit drejt varrezave të fshatit në vend që amfiteatri të jetë i orientuar drejt varrezave të dëshmorëve me skenën për manifestimin vjetor, e cila mungon në projektin ideor, i cili mund të vërehet edhe në imazhin vijues:



Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, Autoritetit Kontraktues i propozojmë që të marrë këtë:

### VENDIM

**APROVOHET** si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomik me shifrën 1111.

Lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** të ofertave dhe pas rivlerësimit shifra 1111 të vlerësohet me pikët maksimale, ndërsa OE me shifrën 2606 dhe OE Polis të shpallen administrativisht të papërgjegjshëm.

### **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Dëmet materiale që shkaktohen janë të konsiderueshme si në fushën financiare, ashtu edhe në fitime të munguara.**

### **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVE  
QEVERIA – VLADA – GOVERNMENT

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS

ZYRA E PROKURIMIT

Datë: 14.12.2023

Ne mbeshitetje te Nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, konkretisht pika paragrafi i 6, si dhe duke marr parasysh kërkesën për Rishqyrtim e dorëzuar nga Operatoreve Ekonomik: 1111 me datë: 06.12.2023 lidhur me tenderin **Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës me numër 207-23-5283-2-1-1 dhe numër të brendshëm 207-23-038-2-1-1.**

VENDIM MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR RI-SHQYRTIM

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore në Ankesën / Kërkesën për ri-shqyrtim të datës 06.12.2023 nga Operatori Ekonomik: 1111 dhe ka vendosur si vijon:

1. **REFUZON** Kërkesën për rishqyrtim si të **PABAZUAR**
2. Vendimi i rishqyrtimit është nxjerr me afat shtesë 6 ditë (të punës) nga dita e paraqitjes së ankesës
3. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 01.12.2023 – Formulari B58.

ARSYETIM

Në pajtueshmëri me kërkesat e njësisë kërkuese, nevojat e institucionit, rëndësinë dhe peshën e projektit Zyra e Prokurimit ka ngritur në platformën elektronike procedurën me titullin **Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës me numër 207-23-5283-2-1-1 dhe numër të brendshëm 207-23-038-2-1-1.** duke analizuar në përpikëri pretendimet e ngritura:

1. Autoriteti kontraktues konfirmon se Operatori Ekonomik POLIS ka shpалosur identitetin e vet në materialet e dorëzuara në formatin fizik.
2. AK hedh poshtë pretendimin e dytë të OE-se. I njëjti e konfirmon që OE POLIS ka dorëzuar USB-në me materiale të projektit .
3. AK hedh poshtë pretendimin e tretë të OE-se. I njëjti e konfirmon që OE me shifrën 2606 ka dorëzuar origjinalin dhe dy kopjet e mbyllura brenda pakos, në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe legjislacionit në fuqi për prokurimin publik për konkurse të projektimit.
4. AK hedh poshtë pretendimin e katërt të OE-së. I njëjti e konfirmon që OE me shifrën 2606 ka dorëzuar USB-në me dokumentacion të projektit, në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Vendim mbi shqyrtimin e kërkesës për ri-shqyrtim në procedurën e prokurimit: **Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës me numër 207-23-5283-2-1-1 dhe numër të brendshëm 207-23-038-2-1-1.**



## Të përgjithshme:

Në kërkesën për rishqyrtim është evidente që O.E. 1111 nuk është përqëndruar në vlerësimin që i është bërë O.E. në fjalë, por i njëjti në një masë, merr rolin e Komisionit Vlerësues Profesional, tutje Komisioni të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues. Ky mandat aktualisht i takon Komisionit, i cili gjatë gjithë kohës së vlerësimit të projekteve ideore, respektivisht pjesën e Kërkesave C - Dokumentacioni teknik - Projekti Ideor, për Zhvillimi i master – planit për Kompleksin Memorial ‘Adem Jashari’ e ka bazuar në kriteret dhe nën-kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit për përmbushjen e Parimeve dhe Objektivave të Projektimit, si dhe në dokumentin e Kriterëve të Vlerësimit, të bashkangjitur më poshtë, të hartuar nga Komisioni i Ekspertëve të Kompleksit Memorial ‘Adem Jashari’, në mënyrë specifike në **kriteret estetike**.

## EVALUATION CRITERIA

The jury will evaluate the quality of the entries based on following criteria which are listed not in order of priority or importance.

**Impact**

- Expressing and reinforcing symbolic, historical and documentary values of the cultural landscape and its tangible and intangible attributes, enhancing its associative values;
- Contributing to sustainable merging of memory keeping and memory-based social development;
- Impact on the urban and social context;
- Reflection of historical analysis and documentation aspects/consideration

**Aesthetics**

- Integration of the newly designed elements into the remains of the historical landmarks, as well as into the historical context in interpretative way;
- Attentive and innovative approach to the interpretative conservation of ruins;
- Overall urban planning quality;
- Architectural quality;
- Innovation and creativity in adaptive reuse and interpretation design concepts;
- Inclusive design of public spaces;
- General Impression;
- Innovative approach to presentation and interpretation of the movable items in a storytelling pattern

**Performance**

- Contextuality of design approach and expression;
- Competency of design approach and expression;
- Coherence of functional approach;
- Coherence of architectural, design approach;
- Coherence of holistic approach;
- Integration into the heritage landscape;
- Ecological aspects;
- Functional aspects;
- Economy of means in the design approach;
- Feasibility and implementation potential;

The jury may expound and detail the criteria during the evaluation process.

O.E. 1111 ka bërë komente dhe krahasime për operatorin tjetër ekonomik, kryesisht nga aspekti subjektiv, duke mos marr për bazë kriteret dhe nën-kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit për përmbushjen e Parimeve dhe Objektivave të Projektimit, e poashtu duke mos marr për bazë kushtet dhe kriteret e dokumentacionit të hartuar nga Komisioni i Ekspertëve.

Po ashtu, Komisioni ka vënë re se O.E. 1111 gjatë vlerësimit që i ka bërë propozimit të O.E. 2606 për zhvillimin e Master – planit për Kompleksin Memorial ‘Adem Jashari’, ka keqkuptuar dhe keqinterpretuar projektin ideor të O.E. 2606, bazuar në vërejtjet shitesë që i ka adresuar në Kërkesën për ri-shqyrtim. Theksojmë se të gjitha pretendimet e ngritura nga O.E. 1111 specifkisht, mosplanifikim i hapësirës për manifestimin e Epopesë së UCK-së, orientimi i amfiteatrit karshi varrezave të fshatit dhe jo atyre të dëshmorëve me skenën për manifestimin vjetor, janë interpretuar gabimisht nga O.E. 1111, dhe të njëjtat janë të paqëndrueshme, referuar dokumentacionin teknik për zhvillimin e Master – planit për Kompleksin Memorial ‘Adem Jashari’ të hartuar nga O.E. 2606.

Megjithatë, Komisioni e sheh të arsyeshme që përveç komenteve të përgjithshme të bëj edhe disa komente specifike, të bazuar në karta dhe konventa ndërkombëtare për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore si dhe në kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Vendim mbi shqyrtimin e kërkesës për ri-shqyrtim në procedurën e prokurimit: Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial ‘Adem Jashari’, në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës me numër 207-23-5283-2-1-1 dhe numër të brendshëm 207-23-038-2-1-1.





- a) Pretendimet e O.E. 1111 se me krijimin e hapësirave sportive ‘synohet të mbahet gjallë Kompleksi Memorial Adem Jashari’, më së lehti thënë është në kundërshtim me parimet e zhvillimit të Kompleksit Memorial Adem Jashari si dhe me parimet e përgjithshme për peisazhet kulturore asociative. Komisioni shtron pyetjen për O.E. 1111 që në cilën pjesë të dosjes së tenderit përshkruhet që fokusi i zhvillimit të master planit duhet të jetë te terrenet sportive, përkundrazi Komisioni konstaton se vendosja e pabalancuar e terreneve sportive, do të ndikoj negativisht në projektin e master – planit të Kompleksit Memorial Adem Jashari, e për më tepër një gjë e tillë as që është kërkuar në Dosje të Tenderit, për përmbushjen e parimeve dhe objektivave të projektimit.
- b) Sa i përket planifikimit të zhvillimit të qëndrueshëm rezidencial, në mënyrë specifike bazuar në kriteret dhe nën-kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, respektivisht në kërkesat e dokumentacioni teknik, të hartuar nga Komisioni i Eksperteve të Kompleksit Memorial ‘Adem Jashari’, është kërkuar: *D është një pjesë e zonës ku mund të jepen leje zhvillimi për ndërtesa banimi, ndërtesa të vogla komerciale dhe turistike, duke përfshirë hotele të vogla, jo agresive nga ana pamore, restorante, dyqane, zyra dhe punishte etj. Konceptet e zhvillimit të saj duhet të afrohen, me përkufizimin e kufizimeve në lidhje me organizimin, formën, funksionin dhe përmasat hapësinore. Konceptet duhet të sigurojnë vazhdimin e përdorimit tradicional të hapësirës dhe organizimit të saj, infrastrukturë e cila do të çlirojë zonat karakter-ndërtuese nga vepra më të mëdha infrastrukturore*, pra vërehet se në asnjë rrethanë nuk është kërkuar planifikimi i blloqeve të banimit kolektiv, të cilat edhe ashtu janë në kundërshtim me parimet për zhvillim të peisazheve kulturore, referuar kartave dhe konventave ndërkombëtare, po ashtu edhe me kërkesave të Dosjes së Tenderit. Kjo është lehtë e vërtetuar nga përshkrimet dhe panelet grafike që O.E. 1111 i ka të shfaqura dhe se ky koncept i projektimit të objekteve të banimit me dendësi dhe lartësi krijon vështirësi serioze për funksionimin e drejtë të Kompleksit Memorial “Adem Jashari”.
- c) Ringjallja e ngjarjeve historike sipas konceptit zhvillimor të Kompleksit Memorial ‘Adem Jashari’, i prezantuar nga O.E. 1111 nuk është i përpiktë dhe i tejkalon objektivat e projektimit, duke mos i përfshirë kërkesat themelore të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe si rrjedhojë, nuk përputhet me temën e vlerësimit dhe prezantimit të sakrificës së familjes Jashari.
- d) Sa i përket trajtimit të Shtëpive të rezistencës, komisioni thekson se O.E. 1111 përveç që nuk i trajton Shtëpitë e rezistencës sipas parimeve të Konservimit dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit: *Planifikimi, konservimi, projektimi dhe komunikimet vizuale duhet t’u nënshtrohen rregullave të rrepta, të cilat përfshijnë ato ndërhyrje që i shërbejnë ekskluzivisht përkujtimit dhe interpretimit sistematik të simbolikës së heroizmit dhe vdekjes së Adem Jasharit, familjes dhe bashkëlloftëtarëve të tij, përfshirë gra dhe fëmijë - në betejën e 5-7 marsit 1998*, po ashtu i lë jashtë trajtimit edhe shtëpitë e rezistencës, sikur është rasti i: Shtëpia Sala and Hamit Jashari dhe Shtëpia e Smajl Jasharit, duke mos u bazuar në kërkesat e Dosjes të Tenderit.
- e) Komisioni konstaton se O.E. 1111 në mënyrë të theksuar tejkalon kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit në prezantimet vizuale, të cilat reflektojnë edhe në raportin teknik të zhvillimit të Master Planit të Kompleksit Memorial Adem Jashari.
- f) Derisa O.E. 1111 me projekt propozimin lidhur me depërtimin e thellë në kuadër të Kompleksit Memorial ‘Adem Jashari’ përmes infrastrukturës fizike rrugore dhe vendparkingjeve në qendër të Kompleksit, konsiderohet dhe gjykohet si dëmtrim i vlerave të zonës, njëkohësisht edhe duke mos respektuar kërkesat dhe parimet si dhe objektivat e projektimit, kërkesat për zonën A1 pjesë të Dosjes së Tenderit, si dhe nuk përputhet me kartat dhe konventat ndërkombëtare për trashëgimi kulturore. Përkundrazi, në dosje të tenderit është kërkuar që zona A1, sidomos në pjesën e









Derisa O.E. 2606 i vlerësuar me më shumë pikë ka prezantuar incorporimin e varrezave të vjetra në kompleks, përmes elementeve minimale infrastrukturore dhe interpretimit, duke i shtuar monumentalitet kompleksit, ashtu siç është kërkuar në Dosje të Tenderit.




O.E. 1111 në konceptin e konservimit të shtëpive të rezistencës, kufizohet në zgjidhje pothuajse ekzistuese, jo kreative, që përdoret zakonisht në projekte të ndërhyrjeve emergjente.

Vendim mbi shqyrtimin e kërkesës për ri-shqyrtim në procedurën e prokurimit: Zhvillimi i master-planit për Komplexin Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës me numër 207-23-5283-2-1-1 dhe numër të brendshëm 207-23-038-2-1-1.





Përpos harmonisë arkitekture, O.E. 2606 ka arrit të zbatoj parimet e konservimit, ashtu sic parashihen me karta dhe konventa ndërkombëtare, duke mos shkaktuar ndërhyrje në strukturë të ndërtesave, përveç atyre stabilizuese, me c'rast me materialin e përdorur është vënë në pah monumentaliteti i sakrificës dhe rezistencës së familjes Jashari dhe i është dhënë jetë e re, që mund të nënkuptoj lirinë e fituar pas vdekjes, ashtu sic është kërkuar në Dosje të Tenderit.



Trajtimi i rezervuarit të ujit nga O.E. 1111 përve që është jashtë parimeve konceptuale të trajtimit, i njejtë nuk është i arrirë as nga pamja arkitektonike dhe si i tillë nuk i përmbush kërkesat sipas Dosjes së Tenderit.





O.E.2606 ka prezantuar trajtimin e rezervuarit të ujit duke e konceptualizuar si të tillë dhe arrin ta shndërrojë atë në një vepër arkitekturale më vete, sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Komisioni përsëri thekson se mbetet në pajtueshmëri të plotë me vlerësimin e bërë për produktet e projektit ideor të dorëzuara/prezantuara, nga Operatorët Ekonomikë për Zhvillimin e Master planit për Komplexin Memorial 'Adem Jashari'.

Komisioni poashtu ri - konstaton se O.E. 1111, produktet e dorëzuara/prezantuara të Projektit Ideor, për Zhvillimin e Master planit për Komplexin Memorial 'Adem Jashari', i ka hartuar duke shfaqur mangësi të fokusit në kriteret e përcaktuara në Dosje të Tenderit, vecanërisht duke mos e trajtuar kompleksin si peizazh kulturor, në përputhje me parimet dhe objektivat e projektimit, kartat dhe konventat ndërkombëtare për trashëgimi kulturore, si dhe me kërkesën e dokumentacioni teknik, të hartuar nga Komisioni i Eksperteve të Komplexit Memorial 'Adem Jashari'.

**Egzon ZARIQI**

Zv. Drejtor / Zyra e Prokurimit

Prishtinë, 14.12.2023

[egzon.zariqi@rks-gov.net](mailto:egzon.zariqi@rks-gov.net)

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, pala e interesuar mund t'i drejtohet OSHP-së në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 109 – Paragrafi 1 i ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligji nr. 05/L-068 dhe Ligji Nr. 05/L-092.







REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI  
PROCUREMENT REVIEW BODY



UNIREF

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS  
PLAÇANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE  
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT



Të dhënat e OE  
Podaci EO  
EO data

Instituti I Shkencës Dhe I Teknologjisë Insi SH.P.K., BREGU I DIELLIT - QENDRA

TREGTARE LOK.NR.42, 10000 PRISHTINË

Përshkrimi  
Opis  
Description

Zhvillimi i master-planit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari', në Prekaz, në  
Komunën e Skenderajt, në Republikën e Kosovës

Numri i prokurimit  
Broj nabavke  
Procurement number

207-23-5283-2-1-1

Shuma / Iznos  
Ammount

€ 2999900 Euro 00 Ct Data / Datum / Date

Me fjalë / Reçima  
In words

2 9 9 9 9 0 0 0 0

Xhirollogaria  
Broj žiroračuna  
Bank account

1 0 0 0 4 3 0 0 7 0 0 0 5 7 5 6

Lëshuar nga  
Izdato od /  
Issued by

OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës  
Potpis i pečat banke  
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërbllim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

b. Kurdo që aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN.

a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €.

b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.